



Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 12.05.2025, mori në shqyrtim praktikat e përgatitura nga drejtoritë teknike të ERE-s, dhe u shpreh si më poshtë:

1. Mbi miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të Bordit të ERE-s më datë 24.04.2025 dhe datë 28.04.2025.
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin prill 2025 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “SunPro” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “NAD Investment” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “HYDROPOWER” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj të tretëve.
8. Mbi kërkesën e shoqërisë “DIMAX ALBANIA” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj të tretëve.
9. Mbi kërkesën e shoqërisë “CONSTRUCTION ENERGY PARTS (C.E.P)” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet hipotekimit) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e shlyerjes së detyrimit ndaj të tretëve.